

Basic Education Program

Fëmija im lexues i mirë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë doracak nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ky doracak është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (Basic Education Program) të USAID-it të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).

Fëmija im lexues i mirë

Ide dhe udhëzime për prindër



HARTUAR NGA

Osman Buleshkaj

DIZAJNI GRAFIK

indesign

BOTIMI I PARË

Gusht, 2013

FALENDERIME

Basic Education Program (Programi për Arsim Themelor) i USAID-it u shprehë falënderime të sinqerta të gjithë kontribuesve në realizimin e këtij doracaku. Falenderime të veçanta zyrtarëve për arsim të përgjithshëm në MASHT dhe fasilitatorëve të Programit për kontributin e dhënë në pasurimin e këtij doracaku.

Falenderim i veçantë po ashtu për prindërit dhe fëmijët e tyre për fotografitë e bëra për këtë doracak.

PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Të kuptojmë se si leximi mësohet në shkollë	9
Çfarë thonë hulumtimet për të mësuarit e leximit?	10
Si të ndihmoj fëmijën tim të mësoj para se të fillojë shkollën?	12
Si të ndihmoj fëmijën tim të bëhet lexues i efektshëm pasi të fillojë shkollën?...	15
Disa aktivitete të veçanta që mund t'i bëni me fëmijët tuaj	17
Listë për kontrollim të leximit nga ana e prindërve	24
Libra të rekomanduar për fëmijë.....	26
Referencat	28

Mirësevini!

Të nderuar prindër, ju jeni mësuesit e parë dhe më të rëndësishëm të fëmijëve Tuaj. Mbështetja juaj e vazhdueshme, inkurajimi dhe angazhimi aktiv është parakusht për suksesin e fëmijës tuaj në praktikën dhe shprehinë e të lexuarit.

Me qëllim që të ndihmojmë çdo fëmijë të bëhet lexues aktiv dhe i sukseshëm, projekti USAID BEP është përkushtuar të ndihmoj Këshillat e Prindërve në shkolla të ndryshme të Kosovës duke ju ofruar disa ide dhe udhëzime për mënyrat e ndryshme për të përmirësuar dhe përforcuar më tutje mënyrat se si fëmijët mësojnë të lexojnë, në shkollë dhe në shtëpi.



Në vitet e para të shkollës fillore, mësuesit punojnë me fëmijët tuaj dhe ju mësojnë atyre shkathtësitë bazë për tu bërë lexues. Mirëpo të mësuarit e leximit kërkon ushtrime të vazhdueshme, më shumë ushtrime se sa fëmija juaj praktikon gjatë një ditë mësimi në shkollë.

Është me rëndësi të mësoni se çfarë ndihme ju ofrojnë mësuesit fëmijëve tuaj në klasë. Për shembull, a ka orë të caktuar dhe hapësirë të caktuar për lexim? Më e rëndësishmja është që ju të angazhoni fëmijët tuaj në aktivitete të thjeshta leximi në shtëpi me qëllim që të nxisni dhe forconi ndjenjën dhe dashurinë për lexim.

Ky udhëzues do të ju ofroj disa ide elementare dhe aktivitete praktike të cilat mund t'ju zbatoni me fëmijët tuaj pas përfundimit të orëve mësimore, gjatë kohës që ju e kaloni me fëmijët tuaj në shtëpi, në rrugë, në pushime apo vende tjera.

Bëjeni leximin në shtëpi një përvojë të paharruar dhe kënaquni me fëmijët tuaj! Është kohë e përbashkët për ju dhe fëmijët tuaj. Kjo është përvojë e paharruar dhe gjithmonë mbetet në kujtesë të fëmijëve tuaj.

Hyrje

Të krijojmë lexues të efektshëm

Sot lexues, nesër mësues! - Margaret Fuller

Të bëhesh lexues i efektshëm nuk është e lehtë. Duhet shumë punë për tu bërë në këtë drejtim. Derisa shumë gjëra në shkollë kanë ndryshuar nga koha kur ju keni qenë nxënës, një gjë ka mbetur e njëjtë dhe **TË LEXUARIT NË SHTËPI ËSHTË PARAKUSHT PËR SUKSES MË TË MADH TË FËMIJËVE TUAJ.**

Për të filluar angazhimet tuaja në këtë proces të rëndësishëm po ju rikujtojmë disa aktivitete të rëndësishme të cilat mund t'i planifikoni për të ndihmuar fëmijët tuaj:



Megjithatë para se të diskutojmë leximin mbani në mend këtë:

Gjëja më e rëndësishme që prindërit mund të bëjnë për të ndihmuar fëmijët e tyre është të bisedojnë me ta. Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit kërkohet një bazë e fortë e të njohurit të gjuhës; kjo ju ndihmon fëmijëve të mësojnë tingujt, pasurojnë fjalorin dhe shkathtësitë e të menduarit. Në fakt, koha që e kalojmë duke biseduar gjatë darkës rezulton në sukses në të lexuar më vonë!



1

Lexoni për fëmijët tuaj duke filluar që në fëmijëri të hershme. Gjeni një libër për fëmijë me tregime interesante dhe bëjeni shprehi të lexoni me zë të lartë nga dy apo tri faqe për çdo ditë.

2

Inkurajo fëmijët tuaj të bëjnë pyetje dhe të marrin përsipër të lexojnë në vendin tuaj. Diskuto fotografitë dhe bëni pyetje lidhur me tregimin.

3

Lexo bashkë me fëmijët tuaj. Gjeni një hapsirë të qetë në shtëpi dhe ftoni fëmijët tuaj të lexojnë afër jush.

4

Të lexuarit dhe të shkruarit zhvillohen natyrshëm së bashku. Nuk është kurrë herët t'i jipni fëmijës tuaj laps e letër. Lejoni të luajnë me shkrimin e tyre: shkruani listën e ushqimeve së bashku, lejoni të shkruajnë në kompjuter, të vizatojnë, të shkarravisin duke shkruar, etj.

5

Kërkoni nga fëmijët të ju lexojnë tregimin e tyre të preferuar. Kjo e ndihmon ngritjen e vetëbesimit dhe nivelin e të kuptuarit të atyre materialeve. Gjithashtu, kjo e bën tregimin më interesant për fëmijën tuaj.

6

Lexo recetat e ushqimeve, shenjat në rrugë dhe njoftimet nëpër dyqane të ndryshme... Ndhmo fëmijët kur rastisin në fjalë të panjohura. Sqaroni ato fjalë.

7

Siguroni materiale për lexim në shtëpi. Nëse në shtëpinë tuaj keni llojllojshmëri revistash, libra të ndryshëm apo gazeta ditore, fëmijët tuaj, në moshë të ndryshme, do të kuptojnë që të lexuarit është burim i kënaqësisë në familjen tuaj.

8

Dhuro libra për ditëlindje apo festa tjera. Kjo dëshmon që ju e pëlqeni dhe e çmoni librin. Kur fëmijët marrin dhurata të tilla atëherë librat bëhen pronë e tyre dhe kjo i gëzon shumë.

9

Anëtarësohuni dhe shfrytëzoni bibliotekën më të afërt - në qytet, fshat, shkollë apo diku tjetër. Vizitoni ato vende bashkë me fëmijët tuaj. Ndhmo fëmijët të marrin kartelat e bibliotekës apo numrin e tyre personal me të cilin fëmijët mund të zgjedhin librat që i pëlqejnë më shumë. Kërko nga bibliotekisti të ju sugjeroj libra të rinjë sa herë që e frekuentoni bibliotekën.

10

Lexoni çdo ditë (libra, revista, artikuj në internet, gazeta ditore) – bëhuni shembull dhe model i mirë për fëmijët tuaj.

Janë vetëm disa ide fillestare për atë se çfarë mund të bëjmë me fëmijët tanë në këtë rrugëtim të rëndësishëm.

Të kuptojmë se si leximi mësohet në shkollë

Mësimdhënësit në vazhdimësi duhet të përcjellin progresin e fëmijëve tuaj në lexim. Në këtë mënyrë ata mund të ndihmojnë fëmijët tuaj në mënyrë adekuate. Si prindër ju duhet të njoftoheni për këto metoda dhe mënyrën se si mësimdhënësit përgatiten për të ndihmuar fëmijët.

Mësimdhënësit e mirë kalojnë kohë të mjaftueshme për të dëgjuar dhe vlerësuar secilin nxënës në mënyrë që të planifikojnë mësimdhënien e tyre për të plotësuar nevojat individuale të secilit nxënës. Ata mund të hasin në nxënës të cilët kanë nevoja të ngjashme prandaj mund t'i vendosin ata në grupe për lexim.



Para se mësimdhënësit të fillojnë planifikimin e mësimit për të përmbushur nevojat e të gjithë nxënësve në klasë, ata duhet të kalojnë kohë të mjaftueshme dhe të dëgjojnë secilin nxënës gjatë leximit. Mësimdhënësit e përkushtuar kanë për qëllim të bëhen edukatorët më të mirë për secilin nxënës në klasën e tyre. Koha dhe përgatitjet e nevojshme për tu takuar individualisht me fëmijë dhe prindër mund të jetë shumë e gjatë. Megjithatë rezultati përfundimtar është i dobishëm për fëmijët dhe mësimdhënësit.

Pasi fillon viti shkollor dhe ju si prindër përcillni përparimin e fëmijës tuaj, veqanërisht aftësinë për lexim, mund të jetë e dobishme të filloni të bëni pyetjet në vijim:

- ***Si do të ndihmoj mësimdhënësi i mirë fëmijën tim të lexoj në shkollë?***
- ***Çfarë mund të bëjnë mësimdhënësit për të ndihmuar nxënësit të lexojnë më mirë?***
- ***Si do të vlerësoj të lexuarit një mësimdhënësi i mirë?***
- ***Çfarë qasje do të përdorin për të vlerësuar fëmijët me vështirësi në të nxënë?***
- ***Çka nëse fëmija im nuk është vlerësuar drejt?***
- ***Cilat standarde kombëtare për vlerësim duhet ti mësoj unë¹?***

Ky material do të ju ndihmoj të gjeni përgjigje në disa nga këto pyetje, mirëpo ju mund të thërrisni shkollën dhe të caktoni një takim me fëmiun dhe mësimdhënësin e tij/saj? Ndani këto pyetje me mësimdhënësit. Pasi ata/o ju përgjigjen tregoni edhe ju se cilat janë përgjigjet tuaja. Të ndihmojmë fëmijët të lexojnë më mirë është përgjegjësi e përbashkët, dhe bashkëbisedimet janë format më të efektshme për të arritur sukses të madh.

Çfarë thonë hulumtimet për të mësuarit e leximit?

Pesë komponentet kryesore të të lexuarit

Keni një jetë të tërë për të punuar, mirëpo fëmijët janë të rinjë vetëm njëherë.
- Proverb polake

Siç u përmend edhe më herët, të lexuarit me fëmijë dhe ndihma që ju ofrojmë për të praktikuar pjesë të veçanta të leximit në mënyrë të madhe ndihmon dhe përmirëson shkathësitë e tyre të të lexuarit. Hulumtimet shkencore tregojnë që ekzistojnë pesë komponente thelbësore të të lexuarit të cilat fëmijëve duhet tua mësojmë me qëllim që ata të mësojnë të lexojnë mirë.

Të rriturit mund të ndihmojnë fëmijët të bëhen lexues të mirë duke praktikuar në mënyrë sistematike këto pesë komponente:

1 Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë ka përgatitur Standardet Kombëtare për Vlerësim të të Nxënit. http://www.masht-gov.net/advCms/documents/UA_standardet.pdf. Programi për Arsim Theme-lor i USAID-it po ashtu ka botuar një udhëzues për vlerësimin formativ dedikuar prindërve i cili do të shpërnda-het tek prindërit përmes mësimdhënësve dhe nxënësve

1

Të njohurit dhe përdorimi i tingujve të caktuar për të formuar fjalë.

Fëmijët duhet të mësojnë të dëgjojnë tinguj në fjalë dhe të mësojnë që fjalët përbëhen nga disa zëra të ndryshëm.

2

Të kuptuarit e marrëdhënieve në mes të shkronjave të shkruara dhe tingujve të folur.

Fëmijët duhet t'i mësojnë tingujt që dalin me rastin e shqiptimit të shkronjat apo grupit të caktuar të shkronjave. Kur e mësojnë se cilin tingull i takon cilës shkronjë ata e kanë më të lehtë të 'dekodojnë' fjalët e reja.

3

Të zhvilluarit e aftësisë për të lexuar një tekst në mënyrë të drejtë dhe të shpejt ose të lexuarit e rrjedhshëm.

Fëmijët duhet t'i njohin fjalët në mënyrë që të mësojnë të lexojnë fjalët shpejtë dhe drejtë me qëllim që të kuptojnë atë që e lexojnë. Kur lexuesit e rrjedhshëm lexojnë fjalët në heshtje, ata i kuptojnë fjalët në mënyrë automatike. Kur lexuesit e rrjedhshëm lexojnë fjalët me zë, ata lexojnë pa vështirësi dhe me të shprehur artistik. Lexuesit e dobët lexojnë ngadal, fjalë për fjalë. Ata përqëndrohen aq shumë në dekodim sa që nuk kuptojnë përmbajtjen që lexojnë.

4

Të mësuarit e kuptimit dhe shqiptimit të fjalëve apo zhvillimi dhe zgjerimi i fjalorit.

Fëmijët duhet në mënyrë të vazhdueshme të zhvillojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre për fjalët e shkruara dhe të folura; kuptimin e tyre dhe mënyrën e përdorimit.

5

Të zbatuarit e strategjive për të kuptuar, mbajtur në mend dhe shprehur atë që lexohet, apo strategjitë e të kuptuarit të tekstit që lexohet.

Fëmijët duhet të mësojnë strategji të ndryshme të të kuptuarit, apo hapat që lexuesit e efektshëm i ndërmarrin për të kuptuar një tekst. Nxënësit të cilët këtë shkathtësi e kanë të përsosur bëhen lexues aktiv dhe lexojnë me qëllim të caktuar (p.sh. mbi bazën e temave/ fushave me interes).

Si të ndihmoj fëmijën tim të mësoj para se të fillojë shkollën?

*Leximi është thesar që e përcjell të zotin kudo që ai/ajo ndodhet.
- Proverb kineze*



- **Bisedoni me fëmijët tuaj dhe ndihmojuni atyre të mësojnë të flasin dhe të kuptojnë kuptimin e fjalëve. Përmend objekte dhe fjalë tjera dhe sqaro ato gjatë bisedës që bëni me fëmijët tuaj. Fjalori i gjerë i ndihmon fëmijëve tuaj të jenë më të përgatitur për të filluar shkollën.**
- **Lexoni fëmijëve tuaj për çdo ditë duke filluar që nga mosha gjashtë mujore. Të lexuarit dhe lojërat me libra janë mënyrë e veçantë për të kaluar kohën me fëmijët tuaj. Ata i mësojnë fjalët më lehtë pasi t'i kenë dëgjuar disa herë.**
- **Gjithmonë përdorni tinguj, këngë, gjestikulacione dhe fjalë që rimojnë për të ndihmuar fëmijët tuaj të mësojnë gjuhën dhe përdorimin e saj të gjerë. Të kënduarit e këngëve së bashku me fëmijët tuaj është shumë e dobishme.**



- **Kudo që shkoni merrni libra për fëmijë apo materiale tjera për lexim. Kjo i mban ata të angazhuar dhe kënaqën gjatë kohës kur udhëtoni në vende të ndryshme.**
- **Ndani hapësirë të veçantë për lexim në shtëpinë tuaj. Mbani librat aty ku fëmijët mund t'i arrijnë lehtë.**



- **Inkurajo fëmijën tuaj të shkruaj. Është në rregull nëse ata vetëm vizatojnë apo "shtiren" se shkruajnë apo bëjnë shkarravina. Me kohë ata do të shkruajnë fjalë të thjeshta apo fjali për të shprehur një mendim.**
- **Fëmijët duhet të dëgjojnë fjalë nga prindërit dhe të tjeret. Për fëmijët, në veçanti për të vegjëlit, televizioni është zhurmë e mërzitshme dhe cilësia e bisedave dhe fjalëve që i dëgjojnë është e dobët.**
- **Mos vendosni TV, laptop apo kompjutor në dhomën e gjumit të fëmijëve. Vendos raftë librash dhe siguro llojlojshmëri librash interesante për fëmijët tuaj.**



- **Ekzistojnë disa programe kompjuterike të cilat ndihmojnë fëmijët tuaj të lexojnë, mirëpo duhet të keni kujdes se si ata e shfrytëzojnë kompjuterin në këto raste. Disa programe të tilla nuk kanë vlerë edukative.**
- **Kufizo kohën dhe programet televizive të cilat ju dhe fëmijët tuaj i shikoni. Më e mira është të ndalni televizionin dhe të lexoni apo luani me fëmijët tuaj. Koha dhe kujdesi që tregoni për fëmijët tuaj janë të rëndësishme për suksesin e fëmijëve tuaj në shkollë.**



- **Gjithmonë ndaluni dhe shikoni fjalët e shkruara në vende të ndryshme, në shtëpi apo jashtë, kur jeni me fëmijët tuaj. Gjithmonë dëgjoni fëmijët për aq kohë sa flisni me ta**

- **Vizitoni bibliotekat, panairët e librit apo vendet tjera ku ofrohen/mbahen librat. Kjo ju ndihmon fëmijëve tuaj të gjejnë librat e duhur për moshën e tyre, ju ndihmon të përdorin librin në forma të ndryshme dhe është mundësi për të parë që libri mund të sigurohet dhe përdoret për qëllime të ndryshme.**



Si të ndihmoj fëmijën tim të bëhët lexues i efektshëm pasi të fillojë shkollën?

Të nxënit nuk përfundon kur fëmijët tanë kthehen nga shkolla në shtëpi. Mos harroni - "ju jeni mësuesit më të rëndësishëm të fëmijëve tuaj."

Të lexuarit me fëmijët tuaj padyshim që do të ndikoj drejtëpërdrejtë në suksesin e fëmijëve tuaj në shkollë. Duke i zbatuar disa strategji të thjeshta në punën me fëmijët tuaj gjithsesi do të ndihmoni fëmijët tuaj të bëhen lexues dhe nxënës të efektshëm. Të lexuarit me zë të lartë, sigurimi i materialeve të bollshme për lexim dhe promovimi i qasjes pozitive ndaj leximit janë vetëm disa mënyra konkrete për të ndikuar fuqishëm në procesin e të mësuarit të fëmijëve tuaj. Ka shumë ide dhe mënyra tjera. Ne po ju përmendim vetëm disa:

- **Ftoni fëmijët të lexojnë me ju për çdo ditë. Nganjëherë ata mund të pëlqejnë të ndajnë një tregim me lodrën e tyre të preferuar.**
- **Lexoni disa herë me radhë librat të cilët fëmijët tuaj i preferojnë më shumë. Ftoni fëmijët të lexojnë bashkë me ju. Përcillni me gisht të gjitha fjalët që fëmija juaj i lexon. Pyet fëmijën tuaj të ju tregoj se cila fjalë vjen në vijim.**



- **Kur lexoni tekste me shkronja të mëdha atëherë përcillni me gisht secilën fjalë. Kjo ju ndihmon fëmijëve tuaj, sidomos në moshë të vogël, të mësojnë se leximi fillon nga e majta në të djathtë dhe se fjala që ai/ajo po e lexon është ajo që po e sheh në tekst.**
- **Diskutoni fjalët e reja. Për shembull: “Kjo shtëpi e madhe quhet pallat. Kush mendon se jeton në një pallat?”**
- **Ndaluni dhe pyetni për fotografitë dhe për atë që po ndodhë në tregim.**



- **Lexoni libra të llojeve të ndryshme për fëmijë duke përfshirë librat e tregimeve dhe përrallave, librat me këngë, me vjersha si dhe librat me informata të ndryshme.**




- **Inkurajoni dhe mbështetni kreativitetin e fëmijëve tuaj duke siguruar ngjyra, letër dhe mjete tjera për punë arti dhe siguroni një hapsirë të veçantë për të paraqitur punën e fëmijëve tuaj.**
- **Vizitoni ndonjë muze, treg të gjelbërt, vende historike, aeroporte, natyrë, parqe, biblioteka, ngjarje edukative dhe vende tjera me interes për ju dhe fëmijët tuaj. Diskuto këto vizita me fëmijët tuaj dhe sqaro rëndësinë që kanë ato.**



*Mos harroni: Të lexuarit e mirë është baza e të mësuarit të mirë.
Fëmijët të cilët nuk lexojnë mirë, nuk mësojnë mirë.
Prandaj, ndihmojuni atyre të jenë të suksesshëm.*

Disa aktivitete të veçanta që mund t'i bëni me fëmijët tuaj



Aktiviteti 1: Lexojmë çfarë na shohin sytë

Kur jeni duke udhëtuar me makinë, duke shetitur në këmbë ose duke ngarë biçikletën së bashku me fëmijët tuaj shikoni dhe lexoni emrat e dyqaneve, pompave të benzinës, kompanive të ndryshme, restoranteve, shkollave e rrugëve të ndryshme; shikoni shenjat e komunikacionit dhe bisedoni për atë se çfarë nënkuptojnë këto shenja për ngasësit e makinave apo për këmbësorët në komunikacion.

Luani një lojë për të parë se kush mund të gjejë më së shumti fjalë të cilat fillojnë me një shkronjë apo tingullin të caktuar (caktojeni të parin e mandej vazhdoni lojën). Gjithashtu mund të kërkontë shkronja, si p.sh. kush mund të gjejë shkronjën “l” në fjalën/mbishkrimin shitore.

Aktiviteti 2: Biseda për një ditë në shkollë

Biseda me fëmijët tuaj lidhur me përvojat e tyre gjatë ditës në shkollë duken më të lehta se sa në të vërtetë janë. Në pyetjen e prindërve “Çfarë keni mësuar sot në shkollë?” zakonisht përgjigjet e fëmijëve janë: “Asgjë” apo “Më shumë kemi luajtur se sa që kemi mësuar diçka.”

Si prindër, në këto raste, mund të bëni disa pyetje alternative për të shtyer fëmijët tuaj të ndajnë ndonjë informatë më specifike për ditën e tyre në shkollë. Si për shembull:

- A mund të më tregoni cilin tregim e keni dëgjuar/lexuar sot?
- Më kë luajtët sot?
- Përqëndrohuni më shumë në pyetjet “pse” dhe “si” ... Cili ka qenë aktiviteti juaj i preferuar? Pse? A ju pëlqeu tregimi që dëgjuat sot? Pse apo pse jo? ... Bëni pyetje të cilat kërkojnë sqarim e jo përgjigje vetëm me një fjalë.

Janë disa pyetje të cilat stimulojnë diskutim më të frytshëm me fëmijët tuaj.

Aktiviteti 3: Të hulumtojmë botën së bashku

Pasuroni përvojat e fëmijëve tuaj dhe ndihmoni ata të ndërlidhin jetën e përditshme me botën rreth tyre duke:

- Vizituar bibliotekën e qytetit/fshatit/shkollës çdo javë për të huazuar libra, CD apo DVD
- Vizituar aeroportin
- Udhëtuar me tren, autobus, veturë prej një vendi/qyteti në tjetrin
- Shikuar kafshët në kopshtin zoologjik apo në ndonjë vend tjetër
- Shetituar në këmbë në qytetin/fshatin ku jetoni
- Udhëtuar me autobus lokal
- Ecur në këmbë ose duke ngarë biçikletat rreth lagjes ku jetoni

Bisedoni me fëmijën gjatë këtyre vizitave dhe udhëtimeve për gjërat që ju rrethojnë.

Aktiviteti 4: Flisni më shumë dhe sqaroni

Shtoni dhe plotësoni fjalitë e fëmijëve tuaj duke shërbyer si shembull se si duhet të jetë një fjali e plotë ose shtoni një fjalë të re ose ide plotësuese. Për shembull:

Fëmiu juaj: Klounët janë qesharak

Ju: Klounët janë shumë qesharak sidomos kur i shkelin këmbët njëri-tjetrit me ato këpucët e tyre me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë.

Merrni shembuj që lidhen me librin e fundit që fëmija juaj ka lexuar dhe për të cilin keni diskutuar tashmë.



Aktiviteti 5: Shkruaj, vizato dhe lexo porositë

- Filloni të mbani një ditar shënimesh dhe shkruani ose vizatoni ndonjë porosi ditore për njëri-tjetrin;
- Kërkoni nga fëmijët tuaj të ju lënë porosi të ndryshme në letër, në fletore, në frigorifer ose të ju shkruajnë përmes postës elektronike;
- Shkruani porosi fëmijëve tuaj dhe vendosni nën jastëkun e tyre, në çantën e shkollës, në kutinë e lapsave/ngjyrave ose në karrigën e tyre ku ulen për darkë.



Aktiviteti 6: Vepro sipas dëshirës së fëmijëve tuaj

Lexoju fëmijëve tuaj libra të cilët përmbajnë tema dhe ngjarje me interes për fëmijët tuaj. Inkurajoni fëmijët tuaj të bisedojnë për atë se çfarë po dëgjojnë/shohin/gjejnë lidhur me atë temë të caktuar. Në këtë mënyrë fëmijët gjithmonë do të gjejnë tema atraktive të cilat ju përfshijnë edhe juve si prindër. Nëse shikojnë një film, program televiziv apo faqe elektronike, bisedoni me ta dhe kufizoni kohën.

Aktiviteti 7: Lexoni së bashku gjërat e përditshme

- Kur gatواني, lexoni udhëzimet në ambalazha apo mbështjellës të ndryshëm;
- Shikoni dhe gjeni së bashku numrat e telefonave të familjarëve tuaj;
- Lexoni recetat së bashku;
- Kërko nga fëmijët tuaj të ju ndihmojnë të gjeni në gazetatat ditore kohën kur do të shfaqet filmi juaj i preferuar apo ndonjë ngjarje/emision tjetër;
- Lexoni së bashku udhëzimet për përdorim të paisjeve të ndryshme shtëpiake;
- Shikoni dhe lexoni së bashku shenjat dhe emërtimet e ndryshme në rrugë;
- Lexoni së bashku udhëzimet për lojëra të ndryshme.

Aktiviteti 8: Shkoni në treg së bashku

- Kur përgatisni listën e gjërave për të blerë, u jepni fëmijëve tuaj letër dhe laps. Ata gjithsesi kanë dëshirë të luajnë me shkrimin e tyre edhe pse të shkruarit e tyre mund të mos ketë kuptim.
- Përgatitni së bashku listen e ushqimeve. Kërkoni nga fëmijët tuaj të shkruajnë emrat e gjësendeve duke i renditur sipas alfabetit, sipas rëndësisë që kanë për shëndetin tonë, sipas preferencës së tyre apo çmimit të paramenduar. Njëherë tjetër kërkoni t'i paraqesin këta artikuj vetëm me nga një shkronjë apo me simbole/fotografi të ndryshme.
- Lexojeni listen edhe njëherë ... a kemi harruar diçka?
- Merreni këtë listë me vete dhe kërkoni nga fëmijët tuaj të mbajnë shënim të gjithë artikujt që i gjeni dhe i vendosin në shportën e ushqimeve.

Aktiviteti 9: Lojë me fjalë

- Luani lojën me 20 pyetje ... Unë mendoj për një kafshë. A mund ta qëlloni kafshën për të cilën jam duke menduar? Ju parashtroni pyetje lidhur me atë kafshë ndërsa unë përgjigjem me Po ose Jo. Parashtroni pyetje si: A është kafshë që jeton në tokë? A jeton në Kosovë? A mund ta gjejmë në kopsht zoologjik? A jeton në ujë? A është gjitar? A është më e madhe se sa një qen? Etj.
- Jam duke menduar për një lloj pemë emri i së cilës rimon me fjalën shkollë. Cila është ajo? Mandej i ndërroni rolet.
- Sot për drekë kemi t-a-v-ë m-e o-r-i-z. Çfarë kemi për drekë?
- Filloni një fjalë (emra njerëzish, kafshësh, qytetesh, profesione apo diçka tjetër) dhe person i dytë, fëmija juaj, vazhdon me fjalën tjetër duke filluar me shkronjën e fundit të fjalës të cilën ju e thoni. Për shembull: ju filloni 'pula', mandej fëmija juaj vazhdon 'ariu', mandej tjetri vazhdon 'urithi', e kështu me radhë.

Aktiviteti 10: Luani lojën “Unë po e shoh ...”

Jeni duke udhëtuar me makinë, shetituar në këmbë ose duke ngarë biçikletën, luani lojën “unë po e shoh ...” duke përmendur vetëm një shkronjë nga emri/emërtimi i asaj çfarë po sheh. Për shembull:

- Po e shoh dikë emri i të cilit/cilës fillon me shkronjën _____. Kush është?
- Unë po e shoh një frut/pemë e cila mbaron me shkronjën _____. Cila është ajo?
- Unë po e shoh një lodër me shkronjën ____ në mes të emrit. Çka po shoh?

Lista mund të zgjerohet dhe të vazhdojë sipas nevojës dhe dëshirës.



Aktiviteti 11: Të luajmë lojën me ritëm dhe rime

- Të mendojmë për 5 fjalë të cilat rimojnë me fjalët plakë; apo mollë; apo djalë.
- Dëgjoni dhe këndonni së bashku ndonjë këngë që rimon; përcjellni rimën dhe këndojeni këngën me fjalë tjera duke mos i humbur rimën por pa u mërzitur për fjalët të cilat i thoni.

Listë për kontrollim të leximit nga ana e prindërve

Udhëzime dhe këshilla:

Lista e mëposhtme e kontrollit mund të jetë e dobishme për të ndihmuar fëmijët tuaj të lexojnë mirë.

Suksesi në shkollë fillon me lexim. Kur fëmijët bëhen lexues të mirë në klasa të ulëta, ka gjasa të mëdha që ata të bëhen nxënës më të mirë gjatë tërë viteve të shkollës dhe më tutje. Megjithatë, të mësuarit e leximit është punë e rëndë për shumë fëmijë dhe nuk duhet asnjëherë të dënoni fëmijët të cilët janë lexues të ngadalshëm.

Përdorni këtë listë kontrolli për të zbuluar fushat në të cilat ju mund të ndihmoni fëmijën tuaj të lexoj më mirë.

Nëse jeni të shqetësuar për progresin/përparimin e fëmijës tuaj, atëherë bisedoni me mësuesin dhe me të tjerët.

Unë i ndihmoj fëmijës tonë të lexoj

Unë ose anëtarët e familjes time:

- I lexojmë fëmijës tonë çdo ditë
- I lexojmë libra që rimojnë.
- Luajmë lojra të thjeshta me fjalë: p.sh. *Sa fjalë që rimojnë me fjalën "mollë" mund t'i gjeni?*
- Identifikojmë shkronjat kudo që i gjejmë
- Lexojmë Abetaren

Fëmija im:

- Mëson rimën, mëson poezi dhe këngë
- Lavdërohet dhe inkurajohet kur ai/ajo reciton poezi

Unë shërbej si shembull i mirë për fëmijën tonë

Unë ose anëtarët e familjes time:

- Lexojmë me kënaqësi dhe gjejmë informacione duke shërbyer si shembull për fëmijën tonë
- Përdorim fjalor dhe materiale tjera për lexim²

² Programi për Arsimit Themelor i USAID-it ka botuar libra të vegjël dhe libra të nivelizuar për fëmijë. Këto libra mund të shkarkohen nga uebfaqja e Programit <http://sq.bep-ks.org/thesari/>

Unë e ndihmoj procesin e të lexuarit të fëmijës tim

Unë ose anëtarët e familjes time:

- Dëgjojmë fëmijën tonë duke lexuar për çdo ditë
- Diskutojmë me të pjesën që ai/ajo lexon
- Këshillojmë fëmijën tonë të lexojë vetëm
- Përfundojmë pjesën e leximit kur fëmija ynë është i lodhur
- Vizitojmë bibliotekën me fëmijën tonë

Fëmija im:

- Parapëlqen që dikush t'i lexojë
- Kënaqet të lexojë për mua
- Lexon vet

Unë ndihmoj fëmijën të pasurojë fjalorin duke biseduar dhe dëgjuar

Unë ose anëtarët e familjes time:

- Gjejmë kohë të bisedojmë me fëmijën tonë çdo ditë
- Kur bëjmë pazar bisedojmë me fëmijën tonë për çmimet, gjërat e ndryshme dhe si të zgjedhim pemë apo perime të mira
- Gjatë gatimit i diskutojmë recetat
- Kur punojmë rreth shtëpisë ne bisedojmë për veglat e punës dhe për çka shërbejnë ato
- Bisedojmë për programet televizive derisa i shikojmë ato së bashku
- Kur lexojmë libra diskutojmë për ngjarjet që zhvillohen
- Kur fëmija na tregon diçka ne ndalemi dhe e dëgjojmë me vëmendje

Unë e përcjell progresin e fëmijës tim në lexim

Unë:

- Gjithmonë informohem për progresin e fëmijës tim në lexim dhe pyes mesimdhënësit për mënyrat që unë mund t'i ndihmojë

Fëmija im:

- Më tregon çka lexon në shkollë

Libra të rekomanduar për fëmijë

Programi për Arsim Themelor i USAID-it ka botuar mini-libra (libra të vegjël) dhe libra të nivelizuar për fëmijë. Këto libra rekomandohen për fëmijë të klasave të hershme që t'i lexojnë së bashku me prindërit në shtëpi apo me mësues/in-en në shkollë.

'Mini-librat'

'Mini-librat' apo librat e vegjël janë 25 libra që Programi ka përgatitur për nxënësit e klasave të hershme. 'Mini-librat' janë të organizuara rreth temave të popullarizuara elementare si stinët, pesë shqisat dhe tema tjera. Përderisa tregimet vështirësohen brenda temave, ato në të shumtën e rasteve përfshijnë gjuhë përsëritëse dhe rimuese, si dhe ndjekin modelet e parashikueshme. Çdo ilustrim i librit e mbështet tekstin për të siguruar të dhëna për lexuesit e vegjël që t'i deshifrojnë fjalët. Librat janë të përgatitur bardh dhe zi në mënyrë që të ngjyrosen nga fëmijët. Programi ka dizajnuar 25 libra të vegjël për të ndërtuar vetëbesimin e fëmijëve si lexues dhe për t'i ndihmuar ata që të fitojnë rrjedhshmëri në të lexuar.



'Mini-librat' mund të shkarkohen nga mësimdhënësit ose prindërit në uebfaqen e BEP (www.bep-ks.org/thesari) dhe pastaj të shtypen, të priten dhe palosen sipas instruksioneve dhe në fund të ngjyrosen dhe lexohen nga fëmijët.



Librat e nivelizuar

Programi për Arsim Themelor i USAID-it në vitin 2012 ka bërë një vlerësim të të lexuarit në klasat e hershme (klasat e dyta), në 40 shkolla të Kosovës. Nga hulumtimi i zhvilluar, ka dalë se fëmijët e klasave të hershme më së dobëti qëndrojnë me të kuptuarit e të lexuarit (lexim-kuptimin) dhe me rrjedhshmërinë në të shprehur. Në mënyrë që Programi të kontribuoj në përmirësimin e këtyre shkathtësive në lexim, ka përgatitur një kurs në fushën e leximit për mësimdhënës; aktivitete edukative të fokusuara në lexim si dhe libra të përshtatshëm për këtë moshë.

Në mungesë të librave të përshtatshëm për nxënësit e klasave të para dhe të dyta, përveç teksteve shkollore, Programi ka përgatitur 20 libra të nivelizuar të cilët i dedikohën fëmijëve të klasave të para dhe të dyta. Librat janë të përgatitur me shumë ilustrime dhe pak tekst në mënyrë që të jenë sa më atraktiv dhe të lehtë për t'u lexuar.



Personazhet në libra janë fëmijë të moshave të njëjta sikur se lexuesit potencial, ndërsa në çdo libër trajtohet një temë e veçantë e cila ka një porosi.



Librat ndahen në katër nivele, pesë libra për nivel, duke filluar nga niveli më i lehtë deri te niveli më i avancuar. Fjalorthi në libra është i limituar duke filluar me 100 fjalët më të përdorura për nivelin e parë dhe të dytë pastaj duke u pasuruar edhe me 100 fjalë të tjera të përshtatshme për nivelin e tretë dhe të katërt. Librat e nivelizuar mund të lexohen edhe në formë elektronike në version interaktiv në <http://libroteka.org/> dhe <http://sq.bep-ks.org/thesari/>

Referencat

- Ayres, L. R. & Paris, S. G. (1994). *Becoming reflective students and teachers: With portfolios and authentic assessment*. Washington DC, USA: American Psychological Association.
- Calgary Reads (2012). Reading at home – 10 things to know. Retrieved July 17, 2012 from <http://calgaryreads.com/reading-tips/tips-for-parentsguardians/10-things-to-know-reading-at-home/>
- Colorado State Library (2010). Reading tips for parents. Retrieved July 17, 2012 from www.ColoradoStateLibrary.org/slreadtips.htm
- Claff G. (2006). *Teacher guide 6: Participation in education. Involving parents and the community in schools*. WYG International.
- U.S. Department of Education, Office of Intergovernmental and Interagency Affairs, Educational Partnerships and Family Involvement Unit, *Reading Tips for Parents*, Washington, D.C., 2003.

Disa ide dhe aktivitete në këtë doracak janë dhënë nga kryefasilitatorët dhe ekipi i Programit për Arsim Themelor të USAID-it.

